



**VENDIM**

**Nr. 86, Date 06.11.2009**

**MBI ANKIMIN E OSSH SH.A. PER VENDIMIN E BORDIT TE  
KOMISIONEREVE Nr.77, DATE 16.10.2009.**

Ne mbeshtetje te nenit 9, te Ligjit Nr.9072, date 22.05.2003, “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, nenit 16 te “Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s”, Bordi i Komisionereve te Entit Rregullator te Energjise (ERE), ne mbledhjen e tij te dates 06.11.2009, mbasi analizoi kerkesen e OSSH sh.a. te paraqitur me shkresen Nr.5120/4 Prot. date 21.10.2009, per ankimin e vendimit Nr.77, date 16.10.2009 te Bordit te Komisionereve te ERE-s dhe argumentat e Auditit Arthur D. Little, te derguara nga OSSH sh.a. me shkresen Nr.5120/6 Prot. date 02.11.2009, dhe relacionin e Drejtorive Teknike te ERE-s per kete ceshtje,

**Konstanton se:**

- Neni 16 i Dispozitave te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s obligon ERE-n te rishikojë një vendim te Bordit te Komisionereve, ne rast se pala ankimuese paraqet prova te reja, te cilat nuk njiheshin me pare dhe si te tilla nuk jane marre ne konsiderate nga organi vendim-marres, ne momentin e marrjes se vendimit perkates. Perseritja e te njejtave argumente, te cilat jane shqyrtuar dhe jane marre ne konsiderate ne procesin e nje vendim-marrjeje, nuk mund te sherbejne si baze per rishikimin e nje vendimi.

Mbeshtetur ne dispozitat e siperpermendura, Bordi i Komisionereve ne shqyrtimin e ankimit te paraqitur nga ana e OSSH-se konstaton se ne te gjithë materialin e paraqitur per te perligjur kete ankim mungojne argumentet ose dokumentet me cilesine e proves se re.

- Deklarata Rregullatore ne paragrafin 4.5. i njej te drejten OSSH-se qe te kryej një auditim te detajuar te humbjeve me qellim qe te verifikojë nivelin aktual te humbjeve per vitin 2008. Nje e drejte e tille buron nga fakti se nese OSSH e konsideron nivelin e deklaruar te humbjeve per vitin 2008 te pasakte, ajo gezon te drejten qe nepermjet procesit te auditimit te vertetoje kete pasaktesi dhe te jape nivelin e sakte te humbjeve per vitin 2008.

Ne kundershtim me kete princip te Deklarates Rregullatore, si ne Raportin e Auditimit ashtu edhe ne argumentat shtese te paraqitura nga Audituesi bashke me ankimin, nuk jepet asnje nivel saktësie qe verteton besueshmerine e rezultateve dhe llogaritjeve te auditimit.

- Ne shkresen percjellese me nr. 5720/4, date 21.10.2009 te OSSH-se lidhur me paraqitjen e ankimit te vendimit nr. 77, date 16.10.2009 te Bordit te Komisionereve te ERE-s, si dhe referuar percaktimeve te permbledhjes se

argumentave shtese te ADL-se, vete OSSH sh.a siguron se te dhenat e sistemit te billingut qe jane audituar dhe marre per baze ne llogaritjet e ADL-se jane te besueshme, nderkohe qe audituesi ne disa raste shprehet se ka arritur ne perfundimin se te dhenat qe jane shfrytezuat per llogaritjet jane te pasakta dhe se ndikojne ndjeshem ne nivelin e pergjithshem te humbjeve ne rrjet. Arritja ne dy konkluzione te tilla plotesisht kontradiktore provon se rezultati i auditit eshte i pambeshtetur, i pasakte dhe per rrjedhoje i pabesueshem.

- Supozimi i paraqitur ne shkresn nr.5120/4 Prot., date 21.10.2009 te OSSH sh.a, se gjate vitit 2008 ka pasur shume kufizime te energjise elektrike dhe per pasoje nje pjese e madhe e kesaj energjie te kufizuar ishte per te mbuluar sa me shume qe te ishte e mundur humbjet, nuk perben asnje argument te qendrueshem dhe aq me pak nje prove shtese. Per t'u konsideruar prove, ajo duhej faktuar me te dhena te sakta se sa ka qene ky efekt dhe metoda e llogaritjes se tij.

- OSSH sh.a. ne kerkesen e saj te dates 21.10.2009 dhe argumentat e Auditit te derguara nga OSSH-sh.a me date 2.11.2009, kane riformuluar te njejtat argumenta qe jane paraqitur ne Raportin e Auditit te Humbjeve te OSSH sh.a per vitin 2008 dhe si te tilla ato nuk perbejne prova te reja ne kuptim te dispozitave te nenit 16 te "Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s"

- Dokumenti i paraqitur nga OSSH me 02.11.2009, i cili permban "Reagimin ndaj Refuzimit te Raportit" nga ana e Auditit, nuk perben prove te pasi rezulton i paraqitur dhe i trajtuar ne seancen degjimore te dates 08.10.2009 dhe i vleresuar nga Bordi i Komisionereve nepermjet Vendimit Nr.77, date 16.10.2009.

Per gjithë sa me sipër, Bordi i Komisionereve te ERE-s

### **Vendosi :**

1. Te mos marre parasysh ne cilesine e provave te reja, argumentat e paraqitur ne "Reagimin ndaj Refuzimit te Raportit te Auditit".
2. Te lere ne fuqi Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.77, date 16.10.2009, "Per Mosmiratimin e Auditit te Humbjeve te OSSHsh.a.per vitin 2008".
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje OSSH sh.a. per kete vendim.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**